



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.07.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Enver Roshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Adelina Rista, Ardiana Jaku, Florenc Spaho, Majlinda Halilaj, Eugen Bojaxhiu, Koçi Tahiri, Roland Xhelilaj, Almira Xhembulla, Ervis Meço, Edmond Stojku dhe Halil Jakimi.

Mungojnë:

Klotilda Bushka dhe Amra Barova.

Të ftuar:

Bardhylka Kospiri - zëvendësministre Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Miranda Pashaj - Drejtoreshë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Eneida Capo - përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

HAPET MBLEDHJA

Enver Roshi – Mirëmëngjesi!

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë do të analizojë sot kalimin nën për nen të projektligjit “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, si komision përgjegjës. Relatore e këtij projektligji është zonja Ardiana Jaku. Komisioni i Ligjeve na ka përcjellë raportin e vetë për këtë projektligj.

Gjithashtu, zoti Gramoz Ruçi ka paraqitur amendamente për këtë projektligj, në cilësinë e deputetit.

Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kemi të pranishëm: zonjën Bardhylka Kospiri, zëvendësministre, Miranda Pashai, Drejtore dhe Eneida Capo, përgjegjëse Sektori.

Ju bëj me dije se ne kemi bërë dy seanca, kalimin në parim të këtij projektligji dhe seanca e dytë u bë me të gjitha grupet e interesit, të cilat kanë përcjellë mendimet e tyre. Komisioni ynë në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë ka sjellë edhe draftin përfundimtar, i cili do të kalojë sot nën për nen.

Pra, sot do ta rishikojmë dhe diskutojmë sërish këtë projektligj për ta finalizuar dhe për ta kaluar në seancën e ardhshme parlamentare, siç është parashikuar.

Në mungesë të relatores, që pritet të vijë më vonë, dua të fillojmë me diskutimin nën për nen të projektligjit.

Për nenin 1 sugjerimi i komisionit tonë, në dakordësi me Ministrinë e Shëndetësisë, është: “Ky ligj përcakton rregullat dhe mekanizmat për përfitimin e asistencës sociale, autoritetet përgjegjëse për garantimin e kësaj të drejte si dhe marrëdhëniet e financimit të ofrimit dhe përfitimit të asistencës sociale”.

UNICEF-i thotë: “Ky ligj përcakton rregullat dhe mekanizmat për përfitimin e asistencës sociale, autoritetet përgjegjëse për garantimin e kësaj të drejte si dhe marrëdhëniet e financimit të ofrimit dhe përfitimit të asistencës sociale”.

Duket që është marrë në konsideratë sugjerimi i UNICEF-it dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit.

Kush është dakord me këtë nen me variantin përfundimtar?

Miratohet.

Neni 2. Nuk ka propozime për këtë nen.

UNICEF-i, Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi kanë bërë disa sugjerime në germat “a” dhe “b”: “Individët, familjet dhe fëmijët në nevojë”, që janë më tepër përcaktime se sugjerime të qarta.

Kush është dakord me këtë nen?

Miratohet.

Neni 3. Është marrë në konsideratë sugjerimi i UNICEF-it dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit ku thuhet: “Ky ligj zbatohet për individët, familjet në nevojë, personat me aftësi të kufizuar në Republikën e Shqipërisë dhe nënat me foshnjat e porsalindura për ofrimin dhe garantimin e asistencës sociale, me përjashtim të kufizimeve të vendosura në nenin 11 të këtij ligji”.

Kush është dakord me këtë nen?

(Diskutim pa mikrofon)

Pra, është bërë një spostim.

Miratohet sipas sugjerimit të komisionit.

Në neni 4, “Parimet e përgjithshme”, thuhet: Parimet bazë, në bazë të të cilave funksionojnë programet e asistencës sociale janë: “Universaliteti, është parimi që përcakton se asistenca sociale është krijuar, funksionon dhe mbikëqyret bazuar në një sistem rregullash ligjore që ofrojnë garanci të mjaftueshme për të zbatuar në mënyrë të njëjtë për përfituesit, të cilët ndodhen në të njëjtat kushte”. Kjo është germa “a”.

Germa “b”: “Drejtësia sociale është parimi që përcakton se çdokush ka detyrimin të sigurojë kushtet bazë të jetesës për veten dhe personat për të cilët ka detyrim ligjor t’i mbështesë dhe çdokush ka detyrimin të kontribuojë me punën, të ardhurat dhe pasuritë për reduktimin e gjendjes së varfërisë së tij/saj, apo të anëtarëve të familjes, veçanërisht fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë që nuk janë në gjendje të kujdesen për veten e tyre”.

Germa “c”: “Mbështetja sociale është parimi që përcakton se personat që përmbushin kushtet për të përfituar, kanë të drejtën e përfitimit në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe për atë kohë sa janë kushtet e vështirësisë dhe pamundësisë”.

Germa “ç”: “Respektimi i të drejtave të njeriut, integritetit, të përfituesit është parimi që përcakton se ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut, integritetit, individit, besimit fetar dhe formimit të gjithanshëm”.

Germa “d” hiqet dhe shtohet më poshtë: “Kofidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale është parimi që përcakton se të dhënat personale të individit janë konfidenciale dhe mbrohen e përpunohen sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Germa “dh”: “Barazia dhe mosdiskriminimi është parimi që përcakton mbrojtjen sociale, e cila ofrohet për çdo individ në nevojë, pavarësisht nga gjinia, feja, mosha dhe aftësitë e kufizuara”.

Germa “e”: “Partneriteti është parimi që siguron koordinimin e strukturave qendrore të qeverisjes rajonale e vendore si dhe partnerët e tjerë në komunitet”.

Ky është propozimi i komisionit. Kush është dakord?

Bardhylka Kospiri – Zoti kryetar, te neni 4, germa “ç” kërkojmë të bëjmë një ndryshim: togfjalëshi “ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror” të bëhet “ofrimi i shërbimeve të asistencës sociale”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është në përputhje me rekomandimin e bërë.

Ilir Pendavinji – Propozoj që edhe nenin 4 ta diskutojmë në parim, të biem dakord dhe pastaj në qoftë se ka ndryshime në pikat e tij, ta hedhim pikë për pikë në votim, sepse krijon konfuzion edhe në rekordet që mbeten në regjistrime.

Enver Roshi – Unë jam dakord me Ilirin, që ta hedhim në votim në parim nenin dhe pastaj të kalojmë pikë më pikë.

(Diskutim pa mikrofon)

Bardhylka Kospiri – Te neni 4, në përputhje me rekomandimin e Komisionerit të Antidiskriminimit, është kërkuar të shtohet si pikë më vete “mosdiskriminimi”. E kemi pasur të përfshirë te germa “b”, “Barazia dhe mosdiskriminimi”.

Ne jemi dakord.

(Mungesë audio)

Enver Roshi – Jemi dakord me këtë nen: “Barazia është parimi që përcakton mbrojtjen sociale, e cila ofrohet për çdo individ në nevojë”?

Bardhylka Kospiri – Jemi dakord me Komisionerin për pikën shtesë “Mosdiskriminimi”? “Të drejtat që burojnë nga ky ligj, i garantohen pa asnjë lloj çdo individ, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, feja, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore e sociale, shtatzënia, përkatësia ose përgjegjësia

prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër”.

Enver Roshi – Unë jam dakord!

Kush është dakord me germën “e” “Mosdikriminimi” me përkufizimin e ri?

Miratohet.

Germa “f” “Partneriteti është parimi që siguron koordinimin”.

Kemi një propozim nga Komisioni i Ligjeve për nenin 4, “Parimet e përgjithshme”, që të bëhet neni 5 i projektligjit dhe neni 5 të bëhet neni 4.

(Diskutim pa mikrofon)

Kalojmë te neni 5. Propozimi i Komisionit të Ligjeve është: “Në kuptim të këtij ligji, temat e mëposhtëm kanë këto kuptime: “Administrator shoqëror”- “Nëpunësi i organeve të vetqeverisjes vendore, i cili vlerëson, verifikon dhe administron procesin dhe dokumentacionin për aplikimin e përfitimit të ndihmës ekonomike, pagesës së aftësisë së kufizuar dhe përfitime të tjera”.

“b”: “Azilkërkues”- “Çdo i huaj apo person pa shtetësi që shpreh në çfarëdo mënyre se nuk dëshiron të kthehet në vendin e tij, si dhe çdo i huaj apo person pa shtetësi që ka paraqitur një aplikim për azil në Republikën e Shqipërisë, për të cilin nuk është marrë ende një vendim përfundimtar, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

“c”: “Bashkësi/Njësi administrative” “Institucioni nën juridiksionin e të cilit personat përfitues sipas këtij ligji ushtrojnë të drejtën për të kërkuar mbështetjen me të ardhurat monetare, ose edhe në natyrë, të cilat u mungojnë pjesërisht ose plotësisht, si dhe për të kërkuar mbështetje për adresimin e situatës së tyre social-ekonomike drejt programeve të tjera shëndetësore dhe të punësim-strehimit”.

“ç”: “Burim jetese” – “Të gjitha mjetet monetare, asetet ose të ardhurat e natyrës, të cilat bëjnë të mundur jetesën”.

“d”: “Familje” – “Një grup individësh që lidhen me marrëdhënie bashkëshortore, marrëdhënie prindër-fëmijë, marrëdhënie ndërmjet anëtarëve të familjes, si dhe kujdestarëve, të cilët jetojnë në të njëjtën strehë”.

“dh”: “Familje kujdestare” – “Një familje alternativ, sipas përkufizimit të dhënë në Kodin e Familjes”.

“e”: “Fëmijë” – “Çdo person nën moshën 18 vjeç, dhe në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se personi është fëmijë, ai konsiderohet “fëmijë” në kuptim të ligjit “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”.

“ë”: “Formulë e unifikuar e pikëzimit” – “Një formulë e pranueshmërisë së familjes për ndihmë ekonomike që përdor koeficiente dhe ndryshore të përcaktuara qartë, të cilët dalin në lidhje reciproke, objektive me statusin ekonomik dhe varfërinë”.

“f”: “Invalid pune” – “Individ, i cili është deklaruar i tillë me vendim të komisionit mjekësor të caktimit të aftësisë për punë, që përfiton nga ligji “Për statusin e invalidëve”.

“g”: “Invalid në nevojë” – “Personi fizik që është jetim, viktimë e trafikimit, viktimë e dhunës së marrëdhënieve familjare”.

“gj”: “Jetim”- “Fëmijë deri në moshën 25 vjeç sipas caktimit të bërë në ligjin “Për statusin e jetimit”.

“h”: “Kryefamiljar” – “Personi sipas kësaj renditjeje babai, nëna, anëtar më i ri i familjes në grupmoshën aktive 18-65 vjeç dhe kujdestari kur të gjithë anëtarët e familjes janë nën moshën 18 vjeç”.

“i”: “Komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar” – “Një ekip i përzgjedhur i përbërë nga 1 mjek, 1 punonjës social, të cilët janë të punësuar pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe janë përgjegjës për kryerjen e vlerësimit biopsikosocial të aplikuesve për përfitimit në para, dhe/ose në natyrë për shkak të aftësisë së kufizuar, bazuar në dokumentet e përgatitura në institucionet shëndetësore, informacionin e marrë nga intervista e zhvilluar, verifikimin dhe shkëmbimin e informacionit dhe misionet e tjera sociale, arsimore dhe shëndetësore të punësimit të formimit profesional”.

“j”: “Ministria përgjegjëse për Çështjet Sociale ndër të tjera ka në fushën e veprimtarisë çështjet e ndihmës ekonomike për personat me aftësi të kufizuar” .

Roland Xhelilaj - Duhet të lexohet për procedurë, se unë jam i mendimit që në qoftë se pika nuk ka ndryshim nga propozimi, të mos lexohet. Në qoftë se pika ka ndryshim, thuhet ndryshimi, shtohet ose hiqet kjo fjalë.

Mua s’më duket e saktë të lexohet i gjithë ligji! Po të jetë se e konsideroni se duhet për procedurë, vazhdoni atëherë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Propozimet ti nuk i kalon një nga një, ti ke marrë përsipër të japësh atë definicion që ka vendosur komisioni dhe ky do të krahasohet me produktin e sjellë nga ministria nëse ka ndryshim ose jo.

Enver Roshi – Unë mendoj që e kam parë të gjithë ligjin, edhe nenin 5, gjithashtu. Kalojmë në parim dhe pastaj shikojmë pikat në të cilat ka vërejtje.

Kush është dakord në parim me propozimin e komisionit?

Ku janë propozimet germë për germë?

Ramë dakord që neni 5 do të bëhet neni 4 dhe anasjelltas. Në përkufizimet e dhëna, Komisioni i Ligjeve ka propozuar që te germa “ë” e nenit 5, të shtohet fjala “individ” para fjalës “familjeve”.

(Diskutim pa mikrofon)

Kush ka propozime të tjera?

Ardiana Jaku - Te pika 1, Fondacioni Shqiptar për Personat me Aftësi të Kufizuar propozon që para fjalës “paraplegjik” të vendoset fjala “person paraplegjik” në të gjithë ligjin ku vendoset kjo fjalë.

Te germa “r” rekomandohet të ndryshohet fjala “rekorde” me fjalët “të dhëna”, se është fjalë e duhur dhe e kuptueshme.

Shtohet edhe një pikë tjetër, germa “zh” “Remitancë” – “Transfertat neto pa kundërshpërblim nga jashtë vendit”. Duhet të shtohet edhe kjo te pjesa e përkufizimeve për nenin 5.

Te pika “h” varianti ka qenë: “Familjar”, personi sipas kësaj renditjeje...”, në përputhje me rekomandimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga diskriminimi përsëri kërkojnë të ndryshohet në: “Personi sipas renditjes në certifikatën familjare”.

Enver Roshi – E hedhim në votim propozimin e Komisionerit. Kush është dakord?

Miratohet.

(Mungesë audio)

Kush është dakord me nenin 6?

Miratohet.

Neni 7, hiqet togfjalëshi “subjektet dhe përfituesit e ndihmës ekonomike”. kush është dakord me propozimin?

Miratohet.

Neni 8, në germën “a” shtohet fjala “personat”. Kush është dakord?

Ka një propozim të ardhur nga deputeti dhe njëkohësisht Kryetari i Kuvendit, zoti Gramoz Ruçi, ku thuhet: “Subjektet përfituese të pagës së aftësisë së kufizuar”, në fund të pikës “b” të nenit 8, të shtohet fjalia “Personat e paaftë për punë, të cilët ndonëse kanë punuar dhe kanë paguar kontribute, nuk plotësojnë kushtet për të përfituar pension nga skema e sigurimeve shoqërore”.

Në argumentin e tij, ai shprehet: “Ky ndryshim u vjen në ndihmë personave të paaftë për punë, të cilët kanë një histori punuese e paguese kontributesh, por që nuk plotësojnë kushtin që të kenë punuar të paktën 1 vit në 5 vitet e fundit. Sipas ekspertëve, nga ky amendim, përfitojnë rreth 3 mijë persona të paaftë për punë. Nuk gjej ndonjë arsye pse ky projektligj duhet të përjashtohet nga sigurimet shoqërore. Siç shihet në amendamentet 2 dhe 3 ka një kosto financiare shtesë, e cila duhet të vlerësohet nga Këshilli i Ministrave.

Përveç 3 amendimeve, programi i ndihmës ekonomike do të zëvendësohet nga programi i shtetit për integrim”.

Këto janë disa argumente që ai jep. Unë jam pro futjes dhe përfshirjes së kësaj shtese në pikën “b”, propozuar nga zoti Ruçi.

Bardhylka Kospiri – Neni, siç është i shkruar këtu, nuk e përjashton, por specifikimet 1 vit në 5 vjet, apo 1 vit në 3 vjet, do të bëhen me VKM të Këshillit të Ministrave, sepse mund të ndryshojnë. Të mos ndryshojmë ligjin vitin tjetër, por të rishikohen kriteret me vendim të Këshillit të Ministrave, por ky nen, siç është shprehur këtu, nuk e përjashton.

Enver Roshi – Kush është dakord me propozimin e zotit Ruçi?

Miratohet me shtimin e sugjerimit të tij në pikën “b”.

Eneida Capo - Mund të bëj një ndërhyrje vetëm për ta sqaruar?

Ky nen nuk bën përjashtime, neni thotë që “përfiton pagesën e aftësisë së kufizuar personi që është komisionuar me vendim të KMCAP-it”, që do të thotë se personi është komisionuar. Për t’u komisionuar ka disa kriteret, të cilat përcaktohen me VKM, mjafton që të mos jetë kriter përjashtues fakti që ai ka periudha kontributive dhe personi automatikisht është përfitues. Pra, kriteret vendosen me VKM.

Është edhe rasti tjetër që ligji për sigurimet shoqërore mund të ketë ndryshime të herëpashershme. Mund ta kufizojë edhe më shumë gamën e personave që ne trajtojmë. Kështu që po vumë këtë përcaktim në ligj, nesër do të na duhet të rishikojmë sërish ligjin. Pra, nuk ka kriter përjashtues. Ligji thotë: “Merr pagesën personi i komisionuar” dhe për t’u komisionuar kriteret

vihen me VKM. Edhe sot në VKM nuk kemi kritere përjashtuese, të paktën në VKM-në nr. 431 që po pilotojmë sistemin e aftësisë së kufizuar biopsikosocial, kemi thënë se ata persona që nuk përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore, trajtohen nga ky program.

Enver Roshi – E hodhëm në votim dhe u aprovua amendimi i ardhur nga zoti Ruçi. E para.

Së dyti, ligji është mbi të gjitha, VKM-të ndryshojnë. Ne po e futëm në ligj, këta njerëz i përfshijmë. Ligjet i bëjmë për njerëzit dhe nuk flasim as për yjet, e as për planetët këtu, por të përjashtosh një kontingjent prej 3 mijë vetash për vetë faktin që nuk kanë paguar 1 vit kontribute, kur një qenieje e gjallë rrëzohet, jo vetëm ato njerëzore, dikush i çon bukë apo ujë kësaj qenie të gjallë, kurse këtij njeriu që aksidentohet, ti nuk i jep asnjë mundësi jetese të jetojë.

Kështu që jam i mendimit që kjo të përfshihet në ligj. Kjo u votua.

Klodiana Spahiu – Ne jemi në proces votimi, por edhe si procedurë, debatin e kemi bërë me grupet e interesit, ndaj ju lutem, në momentin që hidhet në votim dhe merren votat, shpjegimet janë dhënë dhe nuk ka më nevojë për diskutime. Ky është një vendim i komisionit dhe më pas është seanca plenare ajo që do të vendosë nëse ky propozim do të mbetet ose do të rrëzohet.

Ilir Pendavinji – Po që se shikon gjithë ligjin, përcaktimet janë: germa “a”, germa “b”, germa “c”. Këtu pse është pika 1, pika 2, pika 3, se mos është gabim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është paragraf ky këtu?

(Mungesë audio)

Eneida Capo – Fakti që ne bëjmë një përcaktim duke vendosur 150 % të pensionit social, do të thotë se ne vëmë një tavan për ndihmën ekonomike. Pra, ne e hoqëm tavanin prej 8 mijë lekësh dhe prapë po vëmë një tavan tjetër. Ne e kemi hequr fare tavanin dhe nuk ka pse të vihet sërish masë maksimale e ndihmës ekonomike. Ajo është sipas strukturës së familjes ku secili anëtar ka masën e vetë, sado që të dalë masa për familje. Në këtë rast ne vendosim një tjetër tavan, për mendimin tonë si ministri.

Edlira Bode – A keni kritere për këtë? Si përcaktohet nisur nga tetë mijë lekë, që është aktualisht tavani? Kush i përcakton kriteret e llogaritjes, që ta dimë deri në sa mund të shkojë që të kemi një ide? Sepse në qoftë se ne nga 8 mijë lekë na shkon 9 mijë lekë për familje, çfarë kemi bërë kështu?

Eneida Capo – Kjo varet nga struktura e familjes. Kështu që edhe ai tavani, po të vihet 150 % të pensionit social, ndoshta mund të mos arrihet. Ndaj, është më mirë të mos ketë fare tavan.

Masa e ndihmës sipas strukturës ka një masë ndihme të përcaktuar për çdo anëtar të familjes. Ndoshta do të jetë më mirë të rishikohen në një të ardhme kur të përcaktohen masat për anëtarë të familjes, se sa të vihet ky përkufizim. Pra, në këtë rast prapë është heqje tavani dhe vënie tavani.

Enver Roshi – Këtu thuhet që është e indeksuar. Fjala “indeksim” do të thotë që çdo herë që ndryshojnë këto, ndryshon edhe masa 150 %, bazuar në indeksimin e pagave që bëhet çdo vit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është më mirë me përqindje apo me kufi?

Enaida Capo – Këtë 150 % të pensionit social e kemi aplikuar në skemën e re të aftësisë së kufizuar për pagesat e aftësisë së kufizuar. Ndoshta mund të jetë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bardhylka Kospiri – Në ligj është e shprehur përsëri në këtë formë, siç e ka neni, por me VKM detajohen pastaj. Detajohet edhe ajo pjesa që diskutuat më parë lidhur me formulën që ndryshohet, edhe pjesa e masës së përfitimit për secilin person. Ashtu siç e kishim, ishte shumë e kufizuar, që familjet me shumë anëtarë mund të merrnin shumë më tepër, deri te 80 mijë lekë. Ajo që besoj se do të jetë e ardhmja e afërt, që të rishikohet se cila do të jetë masa për secilin person dhe ajo pastaj dikton, sepse duke e vënë kufizimin kështu, do të na duhet ta ndryshojmë sërish ligjin për të kthyer situatën siç do ta donim në të ardhmen në përputhje me zhvillimin ekonomik dhe mundësitë për t’i paguar edhe më shumë. Dëshira është për t’i paguar më shumë, pa diskutim. Por ama, në këtë moment, ne heqim tavanin, është një lloj testimi, le të themi, që të shikojmë ku jemi, sepse nuk e dimë sa është numri i familjeve aktualisht, që mund të përfitojnë më shumë nga ajo që marrin sot.

Ndaj në këtë ligj hiqet tavanin dhe duke e testuar këtë gjë, do të shohim më tej dhe do ta ridiskutojmë se sa duhet të marrë një person edhe në saj të vlerësimeve të tjera që mund të bëhen.

Enver Roshi – Mendimi i ardhur që 75 mijë lekë i takojnë një personi, kurse një familjeje të tërë i jepen 115 mijë lekë sipas këtij ligji, tregon se të ardhurat për anëtarë familjeje janë shumë të vogla. Kjo është dilema që lind, ti nuk e ndihmon të varfërin. Minimumi jetik...

Bardhylka Kospiri – Kryetar, edhe për të sqaruar këtë pjesën tjetër, ne e kemi theksuar edhe me të gjitha zhvillimet e skemës së ndihmës ekonomike edhe te ky ligj që po e përforcojmë më tej, qëllimi është që në këtë skemë të ndihmës ekonomike të rrimë minimalisht sa më pak, që të pranojmë punësimit, pra, të çohen drejt formimit profesional dhe punësimit, se nëse i krijojmë rehati, le të themi, nuk quhet rehati, por kushte më të favorshme, ne edhe tani kemi persona të

skemës së ndihmës ekonomike me të cilët punojmë vazhdimisht, i mbështesim dhe nxisim me të gjitha politikat për të shkuar drejt formimit profesional dhe punësimit. Për momentin, pasi të kalojë periudha e testimit do të shohim se deri kut do të shkojë heqja e tavanit, për të marrë së bashku vendimin me VKM të ndryshuar, që masa e pensionit të parashikohet edhe në buxhet si shtesë, apo si duhet të menaxhohet pastaj. Ky është gjithë qëllimi.

Edlira Bode – Me këtë logjikë, mund të jetë e arsyeshme vendosja 150 % e pensionit social, që, dakord, të rritet për një familje me shumë anëtarë, por jo të rritet më shumë se kaq, se ndryshe nuk i nxisim ata anëtarë që të kërkojnë punë.

Bardhylka Kospiri – Në qoftë se shumë familje me më pak anëtarë se kaq mund të mos ta kapin edhe pjesën e tavanit, kemi familje me shumë pak anëtarë për të cilët 80 mijë lekë janë të mjaftueshme, le të themi, një masë do t'u dalë, por megjithatë, qëllimi është se kemi qenë diskriminues, sepse është përjashtuar kjo masë atyre që meritonin të merrnin më shumë dhe nuk e merrnin dot për shkak të tavanit. Ashtu është shumë mirë, shumë komode, por pa kaluar periudha e vlerësimit, nuk mund të kërcejmë menjëherë me një masë të tillë. Kjo është. Do edhe një planifikim, se ka edhe faturë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e parashikojmë dot sot! Nuk ka një evidencë, le të themi. Ndaj themi, që periudha e heqjes së tavanit do të na mundësojë të kemi edhe evidencat.

Ardiana Jaku - Mund të shtoj diçka? Kur familja aplikon në sistem, në nenin 16, pika 2 përcaktohet që: “Kriteret, procedurat, dokumentacioni si dhe masa e përfitimit të saj, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”, që do të thotë se masa e përllogaritjes për secilin anëtar të familjes, kryefamiljarin dhe fëmijët gjithashtu, futet në sistem? Pra, ideja është se nëse ne e fusim këtë llogarinë 150% të pensionit familjar, praktikisht me këtë sistem të ngritur elektronik që ka gjithë Shqipëria sot, është e mundur, se duhet të shohim pak edhe pjesën teknike, përtej llogaritjes së kostos financiare.

Miranda Pashaj – Në sistem është e përllogaritur sipas strukturës së familjes në bazë të VKM-së. Ata futen në pikëzim dhe marrin masa sipas anëtarëve të familjes. Kështu që nëse vendoset ai tavani pasta, ndryshon e tëra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është e vështirë t'i klasifikosh pastaj nëse vendos tavanin, sepse llogaritet sipas strukturës, nuk ndahet. Secili individ ka një masë përkatëse.

(Mungesë audio)

Ilir Pendavinji – Në fakt, propozimi, siç e justifikon edhe zoti Ruçi, mbase ka një mungesë, sepse nuk e dimë çfarë efekti financiar ka kjo. Kjo duhej diskutuar edhe me Komisionin e Ekonomisë, por edhe me instancat përkatëse, sepse ne mund të themi jo 150 por 200 %, çfarë rëndësie ka, por si mund ta votojmë në qoftë se nuk kemi një relacion nga Ministria e Ekonomisë?

(Mungesë audio)

Bardhylka Kospiri – A mund të bëj edhe një ndërhyrje? Ky ligj ka shumë rëndësi për disa risi që sjell, të cilat mezi po priten të kalojnë nga grupet e interesit. Për shembull, një nga pikat shumë të rëndësishme është vonesa që kemi pasur për pagesat e aftësisë së kufizuar, minimizimi ose anashkalimi i rolit të këshillit bashkiak për votim e të tjera.

Në këto kushte do t'ju lutesha që t'i linim kohë, edhe ky është propozim i drejtë dhe ne e vlerësojmë shumë, por gjërat duhen bërë hap pas hapi, se përderisa me VKM e kemi të mundshme për të riparë edhe një herë se sa do të jetë masa e pagesës për strukturën e familjes, kjo do të na japë mundësinë ta parashikojmë në një buxhet të ardhshëm. Ndaj, do t'ju lutesha, të mos krijojmë pengesë për ligjin sot.

Enver Roshi – Kush është dakord me amendimin e zotit Ruçi?

Kush është pro? 6 vota pro. Kundër? Abstenim?

(Mungesë audio)

Neni 13 “Pagesa e aftësisë së kufizuar”. Shoqata e Invalidëve ka një propozim për pikën 2, që do të kalojë. Pra, të hiqet pika 2. Kush është dakord që kjo pikë të hiqet?

Ardiana Jaku - Kërkesa e Shoqatës së Invalidëve të Punës është që pagesa të vazhdojë edhe pas 48 muajsh nga momenti i punësimit të personit me aftësi të kufizuar. Në fakt, kjo bie në kundërshtim me parimin financiar që kur një individ mbështetet nga një burim financiar, ai nuk mund të marrë dy herë nga po i njëjti burim financiar. Bazuar në këtë parim financiar, bie poshtë propozimi i ardhur nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe nga Invalidët e Punës. Pra, një individ nuk mund të marrë të ardhura dy herë nga i njëjti burim. Ky është argumenti.

Arben Kamani - Kryetar, faleminderit!

Do ta diskutojmë teknikisht: pse brenda 48 muajve ky mund ta marrë dy herë nga i njëjti burim dhe mbi 48 muaj, nuk mund ta marrë?

Bëhet fjalë për një numër shumë të kufizuar njerëzish. Nuk besoj se ka invalidë që do të punojnë më shumë se 4 vjet në një vend pune. Duke llogaritur logjikën mjekësore teknike, është shumë i vogël numri i atyre personave që do të kalojnë 4, 6 apo 8 vjet në një vend pune, sepse vetë situata shëndetësore e tyre një ditë do t'i detyrojë ata që të mos afrohen pranë këtij vendi pune. Ndaj, mendoj që duhet ta heqim pikën 2 të këtij neni, sepse është një numër shumë i vogël. Edhe pse diku thuhet që janë 100 vetë, unë nuk besoj që janë kaq. Diskutohet për disa paraplegjikë që punojnë pranë zyrave të bashkive. Ne e dimë shumë mirë sa e vështirë është të punësosh një paraplegjik, ti sot s'ke as ndërmarrje shtetërore dhe as private që t'i punësojnë këta. Të jemi të bindur që diskutohet për 10 apo 15 veta në të gjithë Shqipërinë.

Faleminderit!

Klodiana Spahiu - Unë kam një pyetje për relatoren ose për ministrinë: sa është numri i të punësuarve paraplegjikë për vitin 2018, në bazë të statistikave tuaja?

Eneida Capo - Ne kemi një shifër nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit, që nuk i referohet vetëm paraplegjikëve, por të gjithë personave me aftësi të kufizuar, sipas së cilës për vitin 2018 rezulton: 108 persona të punësuar në programet e nxitjes së punësimit, 68 persona të punësuar nga ndërmjetësimi për punësim, 115 persona në arsimin profesional dhe 82 persona të tjerë në formimin profesional. Pra, numri i atyre që janë punësuar gjatë vitit 2018 është mbi 100 persona.

Gjithashtu, me projektligjin e ri e kemi rishikuar afatin e mbështetjes së personave me aftësi të kufizuar duke e çuar në 4 vjet, më parë ka qenë 2 vjet mbështetje dhe më pas, me këtë projektligj propozohet të bëhet 4 vite dhe afati fillon që nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit.

Gjithashtu, po të bëjmë analogji me skemën e sigurimeve shoqërore, një invalid pune, i cili përfiton pension invaliditeti nuk mund të punojë asnjë ditë të vetme. Domethënë, atij i ndërpritet pensioni që në momentin e parë të punësimit.

Klodiana Spahiu – Ju bëni analogji me invalidët e punës në këtë rast, apo jo? Po flasim vetëm për personat paraplegjikë. Domethënë, të bëjmë një amendim për këta persona.

Eneida Capo - Ligji mbështet të gjithë personat me aftësi të kufizuar, jo vetëm paraplegjikët, kështu që ky amendim do të bëhet për të gjitha grupet e aftësisë së kufizuar që janë përfituese sipas këtij ligji. Pra, ne nuk mund të bëjmë diskriminim, një pjesë t'i mbështesim dhe pjesën tjetër jo. Ne po themi që këta persona ne i mbështesim për 4 vjet, ndërkohë që skema e sigurimeve shoqërore ia ndërpret automatikisht pensionin e invaliditetit në qoftë se hyn në

marrëdhënie pune. Ne i favorizojmë këta persona për 4 vjet deri sa të konsolidohen në vendin e punës.

Klodiana Spahiu – Edhe një pyetje, ju lutem: si janë praktikat e vendeve të tjera rreth nesh për personat paraplegjikë?

Bardhylka Kospiri – Unë nuk kam një statistikë me vete, por do t’ju ftoja që kur flasim për personat me aftësi të kufizuar, gjithnjë e më shumë të themi “për të gjithë personat me aftësi të kufizuar”, sepse e kemi detyrim konvente dhe të drejtat janë të barabarta. Madje, edhe situata ligjore që kemi sot, që disa kanë status e disa jo, por kemi një ligj të përgjithshëm që do të vijë gradualisht duke i kaluar të drejtat e statusit të legjislacioni bazë, kjo do të jetë perspektiva.

Lidhur me pyetjen tuaj, ka eksperiencat të ndryshme. Ka shtete që bëjnë vlerësimin dhe i mbajnë në skemë, ka shtete që bëjnë vlerësimin mbi bazën e të ardhurave të pagës, pra në qoftë se paga ka një nivel të caktuar, nuk e humbet, në rast se është mbi nivelin e caktuar, atëherë personi e humbet një pjesë të pagesës apo disa elemente që ai merr. Kështu që eksperiencat janë të ndryshme.

Në kushtet e Shqipërisë, Eni e tha që janë favorizuar me këtë 4-vjeçar të vendosur, sepse jemi ende në fazën e reformës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar që pasi të shtrijmë reformën në të gjithë Shqipërinë do të kemi një situatë tjetër, ku do të ndahen më mirë mënyrat, sasia dhe masat e përfitimit.

Almira Xhembulla - Kisha një pyetje. Duke qenë se ka pasur shumë komente lidhur me këtë nen dhe me kërkesat ashtu siç i prezantoi edhe relatori, në fakt pagesa e aftësisë së kufizuar nuk është e lidhur me kushtet sociale-ekonomike. Në kriteret që merren parasysh për të përfituar asistencën sociale, është një faktor, i cili nuk ndikon në marrjen e asistencës. Ata e përfitojnë automatikisht dhe nuk merret në konsideratë si një e ardhur ekonomike për familjen. A nuk do të kishte qenë mirë që ky aspekt të mos ishte përfshirë në këtë ligj, duke qenë se ky është një ligj për asistencën sociale, por të parashikohet në një ligj tjetër?

Unë e mbështes komentimin dhe sugjerimin që kanë sjellë shoqatat e personave me aftësi të kufizuar.

Bardhylka Kospiri – Mund të sqaroj diçka? Te ky ligj duhet të përfshihet, sepse, siç e keni parasysh, ligji nr. 955 i mëparshëm i vitit 2005 ka pasur pjesën e ndihmës ekonomike, të aftësisë së kufizuar dhe shërbimet sociale. Ne tashmë po evoluojmë dhe kemi shkëputur ligjin e shërbimeve shoqërore, që e kemi ligj më vete dhe te ky ligj kanë mbetur vetëm këto dy pjesë. Pra,

ky duhet të jetë pjesë këtu, të paktën siç është shprehur tani, sepse ka qenë pjesë e ligjit të parë. Zhvillimet e mëtejshme pastaj do të shohim si do t'i zgjidhim, se me siguri do të kemi një ndarje, por nuk mund ta heqim...

(Mungesë audio)

Klodiana Spahiu – Zonja zëvendësministre, së pari ju falënderoj për kontributin që keni dhënë në gjithë këto vite në lidhje me mbështetjen që u keni dhënë personave me aftësi të kufizuara!

Duke e zgjeruar grupin, në bazë edhe të konventës, edhe të ligjit për aksesueshmërinë që kemi kaluar bashkë para 5 vjetësh, koha besoj ka qenë e mjaftueshme që të dilnin aktet nënligjore dhe tashmë të kishte një drejtim që edhe ata që e kishin fituar një status, siç është problemi i të verbërve, që tashmë e kanë përfitur dhe personat me aftësi të kufizuara që nuk janë të verbër në këtë rast quhen të diskriminuar, sepse statusi i të verbërve e ka që ata nuk e humbasin pagesën edhe në momentin të janë në marrëdhënie pune, që këtu kemi të bëjmë me diskriminim.

Pika tjetër, që do të doja të theksoja, është se ne duhet ta gjejmë një zgjidhje, sepse, së pari, ne duhet të jemi mbështetës të këtij grupi, pasi janë shumë pak persona. Ju e dini shumë më mirë se ne, sepse ne i njohim problemet e tyre parimisht, ndërsa ju i njihni individualisht këta persona. Mendoj dhe shpresoj të ketë mirëkuptim, ligji është ligj, por të paktën për këtë grup të vogël, e di konventën dhe ligjin, se e kemi kaluar bashkë, por për këtë grup që është shumë pak, nuk janë më shumë se 50 vetë të punësuar në vitin 2018, tjetër se çfarë është bërë, sepse përpjekja jonë ka qenë shumë e madhe, që në të gjitha ligjet që kemi kaluar të përfshijmë edhe invalidët e punës, sepse ata ngeleshin të anashkaluar dhe për këtë kemi bërë një debat shumë të madh me ju dhe me ministrinë që të përfshiheshin edhe ata, dhe tashmë kjo është arritur.

Meqenëse bëhet fjalë për një numër shumë të limituar dhe për t'i nxitur këta persona që të jenë të barabartë me të tjerët, mendoj se kjo pagesë duhet menduar. Nuk e di se si është formulimi, sepse ju thoni që ndarja nuk bëhet, sepse tashmë me konventën ne jemi të detyruar që t'i fusim të gjithë personat me aftësi ndryshe në një grup, por ai që lind me aftësi ndryshe, nuk mund të jetë i barabartë me atë që e fiton aftësinë e kufizuar për shkak të dëmtimit në punë. Është një e drejtë e fituar, megjithatë secili ka opinionin e vetë.

Ka edhe diçka tjetër. Ne kur bëjmë përllogaritjen e ndihmës ekonomike bazuar në skemën e pikëzimit, themi se të ardhurat e invalidit nuk futen. Atëherë, në momentin që ky invalid do të punojë, a do të përllogaritet kjo te formula e pikëzimit?

Bardhylka Kospiri – Po sqaroj vetëm pjesën e parë. Është e vërtetë që unë vij nga shoqëria civile dhe kam luftuar shumë për të drejtat dhe ndodhem në një pozicion që duhet të marr vendim për respektimin e të drejtave. Eksperienca e këtyre viteve flet se personat me aftësi të kufizuar paratetraplegjik, që ju i veçoni, që kanë vështirësi shumë të mëdha në lëvizje dhe komunikim, megjithatë ne kemi kategori të personave dhe të familjeve që kanë persona me aftësi të kufizuar të zhvillimit mendor dhe ata që përcaktohen me reformën e re që tashmë po bëjnë, përcaktohen me 4 nivele të humbjes së funksioneve, edhe ata mund të punojnë. Unë kam kontakte të vazhdueshme me familjarët e këtyre personave se sa të etur e të dëshiruar janë që këta persona të futen në punë (personat e niveleve të lehtë dhe të moderuar), kështu që e gjithë kategoria, në qoftë se do të vendosim një nënndarje vetëm për paratetraplegjikët, unë nuk do të isha dakord, edhe pse i takoj këtij grupi. Është një vendim jo i lehtë për t'u marrë, sepse synojmë gjithmonë të nxisim punësimin.

Ilir Pendavinji - Nga persona me aftësi të kufizuar, ata nuk mund të bëhen papritur të aftë 100% për punë, e kanë fituar KMCA-në, vuajnë, sepse nëse nuk e fitojnë, dalin nga skema dhe jemi në rregull, por në momentin që ata e kanë, pse duhet t'jua heqim këtë pavarësisht se punojnë, në bazë të sëmundshmërisë që kanë. Ata marrin mjekime, trajtime...

Çfarë do të përfitojmë pas 4 vjetësh duke hequr nga skema e aftësisë së kufizuar 100 veta?

Florenc Spaho – Mbështes nenin 13 për të hequr pikën 2, se ligji përveç karakterit financiar duhet të ketë edhe një karakter human. Këta persona të sapointegruar nuk është se pas 4 vjetësh, në mbështetje të asaj që tha edhe Iliri, e fituan aftësinë ndryshe. Besoj që nuk i përkasin të njëjtit grup me aftësi të kufizuar të grupit të dytë, këta janë persona të grupit të parë, mbi 60-70% të trupit të tyre nuk e kanë njësoj si personat e tjerë, kështu që nuk mund të trajtohen në të njëjtën mënyrë si personat me aftësi të kufizuar, të cilët ecin me këmbët e tyre (flasim për grupin e paraplegjikëve), sepse tetraplegjikët është e vështirë të punojnë.

Në qoftë se pjesa e pagesës që marrin në punë është si pasojë e lodhjes, e mundit, e sakrificës që ata duan të integrohen, pjesa e KMCA-së që marrin është e ardhur që i takon për shkak të kontributit që kanë dhënë dhe për paketën financiare që ua siguron shteti shqiptar.

Klodiana Spahiu – Para ca kohësh kemi kaluar ligjin për nxitjen e punësimit dhe morëm vendimin që të ketë një detyrim, tashmë është krijuar edhe fondi për të mbledhur para në raste se një institucion nuk e zbaton ligjin. Në këtë rast mendoj, se nëse do të ishte ashtu, ne duhet ta kishim shkruar aty që ky person me aftësi të kufizuar që punësohet deri në 4 vjet e mban shteti, sepse ai

person që pranon të punësohet, nëse në i vendosim këtë kusht, ai mund të refuzojë që në fillim për shkak të kushtit.

Ndoshta në ligjin për nxitjen e punësimit, ku vumë edhe kriterin për formimin e Fondit Social, mund të kishim bërë një gjë të tillë ku të thoshim se këta persona me aftësi ndryshe, që do të punësohen, 4 vite kanë të drejtë të marrin pagesën që u takon si aftësi e kufizuar, pjesën tjetër të kohës, janë të detyruar të shkëputen nga kjo pagesë.

Eneida Capo – Këto janë disa përcaktime që mund të bëhen nga ky ligj, për sa kohë edhe fondet kalojnë përmes programit të mbrojtjes sociale. Kështu që këto përcaktime duhet të bëhen në këtë legjislacion dhe jo në atë të punësimit.

Duke pasur parasysh që numri është rreth 170 persona për vitin 2018, sipas informacionit që mora sot nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit, duke i mbajtur për 4 vjet në skemë këta persona dhe pastaj duke dalë nga skema e pagesave për shkak se do të jenë integruar në tregun e punës, mund të mbështesim disa persona të tjerë me këto pagesa. Pra, qëndrimi i tyre në skemë pafundësisht ka një efekt financiar për buxhetin e shtetit dhe me këto para mund të mbështeten disa persona të tjerë më në nevojë.

Enver Roshi – Unë mendoj se heqja e kësaj pike e nxit më shumë punësimin. Njëkohësisht, heqja e pagesës së paraplegjikëve invalidëve, me gjithë problematikën e tyre që kanë medikamente, suport për rehabilitim e gjithçka, nuk e kanë aftësinë fizike produktive si një tjetër, ndaj nuk bën sens të jetë kjo pikë. Pika 2 duhet hequr dhe duhet lënë vetëm pika 1 për t'iu ardhur në ndihmë grupeve në nevojë, aq më tepër që unë nuk besoj shumë te numri që dhatë. Besoj se numri i tyre është shumë më i vogël. Unë kam shëtitur dhe nuk kam parë shumë nga këta persona që të futen në punë. Ne e dimë se sa e hapur është shoqëria shqiptare dhe institucionet për t'i marrë në punë këta persona, pavarësisht nga politikat sociale që ne ndërtojmë apo hedhim këtu.

Kështu që unë mendoj që pika 2, sipas propozimit të Shoqatës së Invalidëve të hiqet dhe të mbetet pika 1. Kush është dakord me këtë propozim?

Kush e do fjalën?

Klodiana Spahiu – Insistoj që së paku ta kuptojmë të gjithë: kjo pagë që marrin personat me aftësi ndryshe, një njeri që lind me aftësi ndryshe dhe është paraplegjik, është për të kompensuar punën që do të bëjë kur të jetë në moshë pune, apo që të plotësojë ato nevoja që të ndjehet i barabartë me ne të tjerët?

Lidhur rreth kësaj pyetje dua të kem një mendim të të gjithëve së bashku.

Bardhylka Kospiri – Do të sqaroja këtë gjë: kjo pagesë që sot jepet me para në dorë ka të bëjë direkt me aftësinë e kufizuar, pra atë që ai duhet të kompensojë për shkak të aftësisë së kufizuar. Që sot ne po ngremë shërbime, por ende nuk jemi aty ku duhet me shërbimet që duhet t'u ofrohen dhe që në të ardhmen do të jetë e zgjidhur, pasi do të ketë shërbime direkte. Pra, kjo pagesë që jepet, është për efekt të aftësisë së kufizuar dhe për të plotësuar nevojat e tyre.

Klodiana Spahiu – Nëse ai hyn në punë, kjo pjesë është që ai të plotësojë nevojat e tij për t'u ndier i barabartë me të tjerët. Në qoftë se ai do të krijojë një familje, do të martohet, me çfarë do ta mbajë ai familjen? Si do t'i plotësojë nevojat e veta?

Unë dua të jem shumë e bindur vetë kur ta votoj, se edhe ne nuk e kemi kollaj që votojmë kundër vendimeve të qeverisë, gjithashtu nuk mund të themi se qeveria nuk i do ata, por ne i duam, por dua që kur të bëjmë një gjë, të jemi të gjithë të bindur, që kjo që po bëjmë është gjëja e duhur apo jo.

Adelina Rista - Ideja është se një person me aftësi të kufizuar, edhe pse nesër hyn në punë për një periudhë të pacaktuar kohe, dhe praktika e ka treguar që këta persona, edhe në qoftë se hyjnë në punë, janë të përkohshëm, përsëri mbetet person me aftësi të kufizuar. Janë tjetër gjë të ardhurat shtesë që krijon nga puna, por ajo ndihmë që i jepet si person me aftësi të kufizuar është tjetër gjë dhe duhet t'i qëndrojnë, jo t'i hiqet.

Roland Xhelilaj - Desha të theksoja diçka. Ligji që vjen tenton të përmirësojë situatën në drejtim edhe të këtyre ndihmave që marrin personat me aftësi të kufizuar dhe krahasimi bëhet me ligjin që ka qenë. Në qoftë se ligji i mëparshëm ka qenë 2 vjet dhe ky bëhet 4 vjet, për mua konsiderohet ecje përpara, sepse, siç tha edhe zëvendësministrja, synimi është që gradualisht, me ngritjen e të gjithë sistemit të kujdesit shëndetësor apo këtyre institucioneve që do t'i shërbejnë kësaj kategorie, do të ketë përmirësime të tjera që mund të mos kenë më afat, që të mos u lëvizë paga, të mos u lëvizë ndihma që marrin për të plotësuar ato nevoja jetike për të përballuar situatën që kanë. Pra, jam i mendimit që ligji sot duhet krahasuar me ligjin ekzistues. Ka qenë 2 vjet, bëhet 4 vjet. Në qoftë se kjo konsiderohet pozitive, ne jemi dakord.

Florenc Spaho – Mund ta di përafërsisht sa i shkon pagesa e KEMP-it në fund të muajit një personi paraplegjik? Besoj që edhe punësimi që pretendohet se do të hyjë, nuk është se do t'ju lejë shumë vend që ata të stimulohen për të punuar. Ndoshta këta persona do të bëjnë llogaritjen e një kostoje oportune, sa marrin kur rrinë në shtëpi dhe sa kur punojnë. Në këtë rast ne nuk po i stimulojmë këta persona që të integrohen në shoqëri dhe të japin kontributin e vetë. S'mund të

mendojmë që këta persona vetëm nga pagesa e Kempit do të plotësojnë ato nevoja bazike duke ndenjur në karroca me rrota. Ne duhet t'i stimulojmë të ecin përpara për të dhënë kontributin e tyre në shoqëri për profesionet apo zanatet që kanë zgjedhur.

Arben Kamami – Më falni që po ndërhyj, po kështu po bëjmë edhe debat!

Po të diskutojmë për pagesën financiare të këtyre personave, është relativisht e lartë, duke llogaritur edhe pagesat si invalid si paraplegjik dhe gjithë paketa mbrapa, plus paga, pagesa e këtyre shkon e lartë, madje nga pagat më të larta që ekzistojnë në shtetin shqiptar. Kjo gjë realivisht të demotivon për të kërkuar punë.

Ka familje të tëra që jetojnë me pagesat e invaliditetit pa u sistemuar në punë, familje që rrojnë me pagesat e invaliditetit të fëmijëve që kalojnë 1 milion lekë të vjetër, po ta llogarisim kështu. Por ne duhet ta llogarisim nga ana morale. Unë si mjek mendoj që një person me aftësi të kufizuar, se u kapëm me grupin e paraplegjikëve dhe po vazhdojmë me ata, me çfarëdo sëmundjeje që të kufizon aftësinë për të punuar dhe jetuar, nuk ka jetëgjatësi të punojë për një periudhë të gjatë kohe. Unë mendoj se po ta limitojmë një periudhë të caktuar kohe, nuk di ta them, vetë natyra e sëmundjes kronike nuk i lejon këta njerëz të vazhdojnë të punojnë gjatë.

Faleminderit!

Ardiana Jaku – Në fakt, u tha edhe këtu dhe shumë mirë që e diskutojmë, ligji më parë e përcaktonte pagesën për 24 muaj, ndërsa ky ligj 48 muaj. Nga ministrja na u tha, në fakt, (nuk është e shkruar dhe diskutuam bashkë se si do të rregullohet) që ndërpritet vetëm pagesa e individit, jo përfitimet e tjera, që do të thotë se paketa higjenosanitarëve e paratetraplegjikëve vazhdon pagesa e kujdestarit, pra ato nuk ndërpriten asnjëherë, vetëm pagesa e individit. Besoj se edhe kjo duhet menduar dhe konsideruar nga secili prej nesh.

Nga ana tjetër, nga eksperiencia që kam pasur gjatë punës në këtë fushë, personat, të cilët kanë arritur të punësohen janë kryesisht, ose të verbrit, që nuk përfshihen fare në këtë ligje, ose paratetraplegjikët. Kjo është diskriminuese. Në fakt, po të hysh t'i bësh llogaritë, një paraplegjik, i cili punësohet, pagesën minimale e ka 170 mijë lekë, ndërkohë që pagesa që ai merr është 100 mijë lekë. pra, ne nuk po e cenojmë askund, përveçse po e mbajmë edhe për dy vjet të tjera këtë person me pagesën e aftësisë së kufizuar. Ne duhet t'i kërkojmë ministrisë dhe qeverisë të rrisë pagesat për personat me aftësi të kufizuar të diagnozave të tjera, se janë për shembull, individët autik, të cilët nuk e përfitojnë kujdestarinë por duhet të vinë në kemp epror që ta marrin. Aty duhet

të kemi më shumë debat, në fakt, sesa për këtë pjesë, ku ato mbështeten, në KEMP-in epror, me kriteret mjekësore që janë marrin vetëm pagesën e aftësisë së kufizuar.

Ky është mendimi im.

Bardhylka Kospiri – Do të doja të bëja edhe një sqarim: paratetraplegjikët kanë pagesë goxha të lartë, sepse u shtohet edhe pagesa e paketës higjenosanitare.

Dy vajza të reja epileptike, që unë gjithmonë i kam ndjekur, nuk arrijnë të punësohen, sepse duan pak më shumë motivim dhe për këtë pjesë ka nevojë të ketë një diferencim, pra, të mos shikojmë vetëm pagesën më të lartë, por edhe pagesën minimale.

Si ministri mendoj se deri këtu e kemi bërë detyrën tonë, por kjo nuk do të thotë që në të ardhmen të mos bëjmë gjëra më të mira.

Enver Roshi - Ne bazohemi në kriterë shumë humane, kriteret e mbështetjes sociale dhe për aq kohë sa shoqëria shqiptare nuk ka siguruar institucione përkatëse për t'i mirëpritur këta njerëz, atëherë jam i mendimit dhe e mbështes shoqatën e invalidëve që pika 2 të hiqet. Për mua është nonsens.

Kush është dakord me këtë propozim? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 14.

Nuk ka sugjerime. Komisioni i Ligjeve nuk ka bërë sugjerime, gjithashtu.

Kush është dakord me nenin 14? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te kreu IV “Kriteret, procedurat dhe përfitimi nga programet e asistencës sociale”.

Neni 15. Sipas komisionit, te pika “ç” hiqet fjala “shumë”.

Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 16 “Aplikimi dhe përfitimi i ndihmës ekonomike”.

Komisioni i Ligjeve ka sjellë një sugjerim: pika 2 e nenit 16 sugjerohet të riformulohet duke hequr paragrafin e dytë të pikës 2, për arsye se është përsëritje e panevojshme dhe jashtë kontekstit të pikës 8 të nenit 12 ku përcaktohen procedurat dhe dokumentacioni për përfitimin e ndihmës ekonomike. Pra, nuk ka sens që paragrafi të përsëritet.

Ardiana Jaku - Në fakt, te pika 2 përcaktohet se si duhet të aplikojë familja, cilat procedura ndiqen nga administratori social, cilat janë dokumentacionet që lidhen me aplikimin e

familjes, ndërsa pika 3 përcakton formulën si llogaritjet formula e pikëzimit nëse një familje është përfituese apo jo dhe masa e përfitimit për çdo anëtar të familjes . Pra, janë dy gjëra të ndryshme dhe të dyja duhen rregulluar me VKM. Kështu që duhet të qëndrojmë.

Enver Roshi – Kush është dakord?

Zoti Ruçi ka sjellë një propozim që në fund të pikës 3 të shtohet fjalia “Algoritmi i ndërtimit të formulës së unifikuar të pikëzimit, të bëhet publik”.

Kush është dakord me propozimin e zotit Ruçi për pikën 3 të nenit 16?

Bardhylka Kospiri – Te kjo pjesë do të doja të sqaroja se ne e theksuam që të gjitha do të bëhen transparente në VKM, pra jo te ligji, por duhen futur në VKM. Të gjithë treguesit e formulës lëvizin gjatë gjithë zhvillimit, kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik, me nivelin e varfërisë sipas të dhënave e të tjera.

Enver Roshi – Çfarë i prish ligjit kjo? Unë mendoj që të shtohet propozimi i zotit Ruçi.

Bardhylka Kospiri – Do të thosha, pa përmendur algoritmin, sepse është shumë teknik dhe nuk ka vlerë të bëhet publike.

Enver Roshi – Atëherë duhet të themi që formula bëhet publike.

Komisioni i Ligjeve në pikën 3 të nenit 16 sugjeron: “Pranueshmëria në skemën e ndihmës ekonomike bëhet nëpërmjet formulës së unifikuar të pikëzimit, treguesit e së cilës mbajnë parasysh gjendjen e varfërisë. Treguesit e vlerësimit të formulës së unifikuar të pikëzuar për përfitimin e ndihmës ekonomike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Bardhylka Kospiri – Në VKM do të sqarohen të gjitha, por bërja publike në detaje kërkon vitet e veta të maturisë në kohë, sepse edhe shtetet si Gjeorgjia e bënë transparente në fund fare, pas 10 vjetësh, pasi u konsolidua skema dhe pasi u bënë ndërhyrjet e tjera. Ne të gjitha i kemi publike sot, por nuk mundet që çdo person të bëjë llogaritjen, pasi edhe unë që vij nga shkencat ekzakte nuk e bëj dot atë formulë, sepse duhet statisticien ta bëjë atë llogari, nuk e bën dot kushdo. Pra nuk është kaq e thjeshtë që çdo person të shkojë te administratori social, të shohë tabelën ose ta marrë nga VKM dhe të thotë po e llogaris vetë sa më del. Nuk është kaq e thjeshtë, janë shumë komponentë dhe ndryshore që e bëjnë një të tërë dhe japin vlerën në fund.

Ndërsa në këtë rast, e gjitha do të jetë transparente në VKM-në që do të dalë, por pjesa teknike, të themi, nuk mund të jetë e tillë, e hapur fare, sepse nuk arrijnë dot ta bëjnë, plus pastaj që ndikon në pjesën e abuzimit, në qoftë se bëhet në masën që mendohet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk arrin dot ta përllogarisë.

Ilir Pendavinji – Një njeri i zakonshëm që do të ulet e të shikojë sa pikë përfiton nga skema me këto kushte që ka, nuk arrin dot ta bëjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vetëm nga frika e abuzimit se çfarë ka ndodhur në vitet e kaluar.

Enver Roshi – Po çfarë të keqe ka nëse themi të bëhet publike? Kur të bëhet VKM-ja të bëhet publike.

Atëherë, duhet ta përfshijmë fjalën “publike”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është e rëndësishme.

E hedhim në votë ligjin.

Miratohet.

(Mungesë audio)

Pra, është ndryshuar titulli i nenit 17, në pikën 1 “Përfitimi i pagesës nga personat me aftësi të kufizuar”, e cila inserohet e gjitha në pikën e parë, në pikën e tretë dhe në të gjitha pikat e ardhshme ku kërkohet të zëvendësohet. Vetëm ky sugjerim është.

Nga Komisioni i Ligjeve nuk ka komente. Hedhim në votim variantin e ardhur? Kush është dakord?

Miratohet neni 17.

Neni 18. Nuk ka komente dhe sugjerime.

Miratohet varianti i ardhur.

Neni 19 “Trajtimi dhe administrimi i programeve të asistencës sociale. Roli i ministrisë përgjegjëse për Çështjet Sociale”. Nuk ka sugjerime dhe rekomandime.

Miratohet.

Neni 20 “Roli i shërbimit social shtetëror”. Nuk ka komente dhe sugjerime.

Miratohet.

Neni 21 “Roli i Këshillit Bashkiak”. Nuk ka komente dhe sugjerime.

Miratohet.

Neni 22 “Roli i strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki”.

Miratohet.

Neni 23 “Roli i administratorit shoqëror i njësisë administrative”. Ka një sugjerim te ky nen: germa “e” zëvendësohet me germën “a”. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 24 “Financimi i programeve të asistencës sociale”. Kush është dakord.

Miratohet.

Neni 25 “Programimi i fondeve”. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 26 “Transferimi i fondeve”. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 27 “Kontrolli i fondeve”. Te ky nen është bërë një ndryshim në paragrafin e fundit: “Me legjislacionin në fuqi për auditimin e brendshëm në sektorin publik, legjislacioni në për menaxhimin e sistemit buxhetor”. Kush është dakord me sugjerimin e ardhur për këtë nen?

Miratohet.

Neni 28. Në germat “a” dhe “b” shtohet: “legjislacioni në fuqi për kundërvajtje administrative” dhe te germa “b” “Sipas legjislacionit në fuqi për nëpunësit civil ose Kodin e Punës”. Kush është dakord me këtë nen?

Miratohet.

Neni 29 “Ankimimi”. Në pikën 4, paragrafi i fundit sugjerohet: “Legjislacioni në fuqi për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Kush është dakord me këtë reformulim?

Miratohet.

Kreu IIIV “Dispozitat e fundit kalimtare”.

Neni 30 “Vlerësimi biopsikosocial i aftësisë së kufizua”. Nuk ka ndryshim te ky nen.

Miratohet.

Neni 31. Nuk ka sugjerime. Kush është dakord.

Miratohet.

Neni 32. Pika 1: “Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit të nxjerrë akte nënligjore në zbatim të neneve”.

Pika 2: “Ngarkohet ministri përgjegjës për Çështjet Sociale brenda iks muajve”. Sa do ta lëmë këtë?

Komisioni i Ligjeve propozon “brenda 3 muajve”.

Bardhylka Kospiri – Propozimi ynë është “brenda 9 muajve”, sepse janë të gjitha aktet nënligjore, edhe ndihma ekonomike, edhe aftësia e kufizuar.

Enver Roshi – Edhe unë jam pro për “brenda 9 muajve”.

Miratohet varianti i komisionit “brenda 9 muajve”.

Te pika 3 e këtij neni, Komisioni i Ligjeve ka sugjeruar: “Ngarkohet ministri përgjegjës për gjendjen civile, ministri përgjegjës për Shëndetësinë (pra, hiqet lidhëza “dhe”) dhe ministri përgjegjës për Çështjet Sociale për nxjerrjen e udhëzimeve të përbashkëta në zbatim të nenit 9, pika 3 e këtij ligji”. Unë jam dakord me propozimin e ardhur nga Komisioni i Ligjeve. Kush është dakord?

Eneida Capo – Ne kemi menduar që pika 3 e nenit 9, pasi u përcaktua që të rregullohet me VKM. Për rrjedhojë, kjo pikë duhet hequr.

Enver Roshi – Ka sugjerime të tjera për këtë pikë? Pika 3 bie poshtë.

Miratohet.

Neni 33 “Shfuqizime si dhe çdo akt tjetër që bie në kundërshtim me të, shfuqizohet”. Ky është propozim i komisionit. Kush është dakord?

Eneida Capo – Para se të votohet projektligji në tërësi, do të doja të bëja një ndërhyrje: me të gjitha ndryshimet që janë bërë deri tani, projektligji sjell një efekt financiar minimalisht 530 milionë lekë të rinj në vit.

Klodiana Spahiu - Sa për sqarim, dhe jo për të bërë debat, meqenëse ju jeni përfaqësuesja e ministrit, vendimet që merr komisioni nuk janë përfundimtare. Këto vendime që kemi marrë do të votohen në seancë plenare.

Mos u shqetësoni, se përgjithësisht nuk votohen në seancë plenare, se aq sa të dhimbsen 5 milionë lekë, po aq na dhimbsen edhe neve!

(Diskutim pa mikrofon)

Ju keni të drejtë. Kur është bërë propozimi, është caktuar që kjo ka një efekt financiar, te propozuesi. Propozuesi ndoshta duhet ta kishte çuar te Komisioni i Ekonomisë, megjithatë, ne duhet t’ia përcjellim këtij komisioni dhe duhet të marrim edhe opinionin e tyre, sepse ky është një ndryshim, të cilin ata nuk e kanë kaluar. Nuk jam në dijeni nëse zoti Ruçi i ka çuar propozimet e tij te Komisioni i Ekonomisë, apo jo?

(Diskutim pa mikrofon)

Ju lutem, si mendoni, do të duhet çojmë te ky komision para se ta votojmë përderisa sa ka një efekt të tillë financiar?

Atëherë, zoti kryetar, bëjmë propozimin që të kalojë te Komisioni i Ligjeve dhe Komisioni i Ekonomisë.

Enver Roshi – Para se ta kalojmë në votimin përfundimtar në parlament propozimin, pasi ka efekt financiar, do ta kalojmë te Komisioni i Ekonomisë.

Roland Xhelilaj – Bëhet fjalë për nenin 13, pika 2, që u hoq.

Enver Roshi – Para se ta kalojmë për votim të gjithë ligjin, do t'i propozojmë Komisionit të Ekonomisë të japë argumentet e veta për heqjen e pikës 2 të nenit 13.

U vendos që neni 8 dhe neni 13 nuk do të kalojnë pa marrë edhe mendimin e Komisionit të Ekonomisë. Pas kësaj, ne do të mbledhemi sërish për ta kaluar ligjin në tërësi.

Klodiana Spahiu -Në fakt, në momentin që bëhet amendimi ose propozimi, që ka bërë zoti Ruçi, ajo duhet të kishte edhe një përlllogaritje, ose i çohet qeverisë apo ministrisë ta bëjë këtë llogaritje, se Komisioni i Ekonomisë nuk mund ta bëjë këtë gjë. Komisioni i Ekonomisë mund ta rrëzojë propozimin tonë, por llogarinë sa shkon kostoja ose e bën propozuesi, ose e bën qeveria dhe vjen me një vendim në një moment të dytë.

Bardhylka Kospiri – Përderisa propozimet ishin përtej ministrisë, jo nga ministria brenda, janë grupet e interesit, vendimet tuaja këtu, kështu që i takon propozuesve ose me kërkesë të tyre të bëhet ky lloj vlerësimi.

Enver Roshi – Mendimi im është që ta kalojmë ligjin me propozimet tona dhe pastaj në seancë të flasim për ndryshimet e duhura.

(Mungesë audio)

Si është menduar nga qeveria për t'i ardhur në ndihmë shtresave në nevojë? Politikën e kemi për njerëzit, jo për ata që janë në hënë!

Bardhylka Kospiri – *(Mungesë audio)* ...mbulimit për nevojat që kanë, pa diskutim, që të gjithë e ndajmë së bashku. Fatura financiare që është diskutuar gjithë këto vite, të parashikohet në buxhet. Pa diskutim që ata duhet të marrin një shërbim, në Shërbimin Social apo në ISSH, domethënë, të gjithë te kjo e kemi qëllimin, por çfarëdo vendimi që do të merret, duhet të ketë një faturë financiare që të mbulohet.

(Diskutim pa mikrofon)

Arben Kamami - Zonja zëvendësministre, deri tani, edhe pse nuk ka ekzistuar ky ligj, këta nuk janë paguar, ose janë paguar por janë gjetur rrugë të jashtëligjshme, si: është bërë një sigurim i përkohshëm i një viti pune, unë kam punuar 18 vjet tek ato komisione dhe e di si bëhet. Realisht, kjo kosto është paguar nga shteti, e aprovojmë apo jo ne sot. Janë gjetur mënyra të tjera dhe është bërë.

Bardhylka Kospiri – Do të doja të sqaroja se mund të ketë pasur raste sporadike ose raste të veçanta që kanë synuar dhe kanë arritur ta përfitojnë në këtë formë, le të themi në kompromis me komisionin, por në tërësi, si masë, këta njerëz nuk kanë qenë përfitues.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Që nga muaji janar i vitit 2015 filloi zbatimi i këtij ligji dhe atëherë filloi pjesa e diskutimit.

Enver Roshi – Edhe me VKM, është ky fond, edhe me ligj e njëjta gjë, ndaj më mirë t’ua japim me ligj sesa me VKM. Këtu nuk shoh ndonjë diferencë mes tyre, derisa kostoja është e njëjtë.

(Mungesë audio)

Kush është dakord ta kalojmë në tërësi me ndryshimet e propozuara?

Miratohet ligji në tërësi me ndryshimet e propozuara dhe amendimet e zotit Ruçi.

(Mungesë audio)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.07.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Enver Roshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nën për nen i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9636, datë 06.11.2006 “ Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”.

Marrin pjesë:

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Adelina Rista, Ardiana Jaku, Florenc Spaho, Majlinda Halilaj, Koçi Tahiri, Roland Xhelilaj, Almira Xhembulla Ervis Meço,.

Mungojnë:

Klotilda Bushka, Eugen Bojaxhiu, Edmond Stojku, Halil Jakimi dhe Amra Barova.

Të ftuar:

Mira Rakacolli - zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Vjollca Braho – Kryeinspektore e ISHSH-së

Nexhila Kodra - përgjegjëse sektori, Drejtoria Juridike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

HAPET MBLEDHJA

Enver Roshi – Hapim mbledhjen e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë për shqyrtimin nen për nen të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9636, datë 06.11.2006 “ Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”.

Relatore e këtij projektligji është zonja Edlira Bode.

Komisioni për Integrimin European ka sjellë mendimet mbi raportin e projektligjit.

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin gjithashtu kanë sjellë mendimet e tyre për këtë projektligj.

Kemi të pranishëm sot nga Ministria e Shëndetësisë, profesoreshën Mira Rakacolli, zëvendësministre; Geraldina Prodani, sekretare e Përgjithshme, nuk është prezent; Vjellca Braho, kryeinspektore ISHSH-së dhe Nexhila Kodra, përgjegjëse sektori e Drejtorisë Juridike.

Ky projektligj vjen për shqyrtim nen për nen pas seancës dëgjimore që bëmë me OBSH-në dhe grupet e interesit.

Kam konfirmimin nga Ministria e Shëndetësisë që të gjitha sugjerimet e OBSH-së janë pasqyruar në ligj edhe nga relatorja.

Për vazhdimin dhe kalimin nen për nen të ligjit po ia jap fjalën relatores.

Edlira Bode – Faleminderit, kryetar!

Siç tha edhe kryetari, ligjin e kemi kaluar të gjithë në parim. Unë po filloj me ndryshimet që propozojmë si komision për projektligjin që ka paraqitur ministria.

Në nenin 1, që ndryshon nenin 3 të ligjit aktual, ministria ka sjellë një përkufizim për pikat 1 dhe 7. Të gjithë ju i keni para të ilustruara në tabelë, qoftë propozimin e ministrisë, qoftë propozimet e ardhura nga grupet e interesit.

Në fakt, si Komision i Shëndetësisë bëjmë një propozim: në pikën 18 të nenit 3 të shtohet pas përcaktimit “plotësisht me mure” të shtohet përcaktimi “dhe çdo lloj materiali tjetër”. Ky është i vetmi ndryshim që kërkojmë të bëhet, sipas variantit të paraqitur nga ministria.

Ju ftoj, zoti kryetar, ta hidhni në votë nenin 1 me ndryshimin që propozon Komisioni i Shëndetësisë.

Enver Roshi – Kush është dakord me propozimin?

Miratohet.

Edlira Bode – Për nenin 2 nuk propozohet asnjë ndryshim, ndaj propozoj të hedhim në votë variantin e ardhur nga ministria.

Enver Roshi – Kush është dakord?

Miratohet.

Edlira Bode – Për nenin 3 kemi një riformulim, edhe këtë të diskutuar dhe dakordësuar me ministrinë, pasi bëhej fjalë për shtim pikash apo paragrafësh. Ë

shtë gjetur një kompromis dhe është bërë një riformulim.

I ftoj kolegët ta votojnë nenin 3, siç e propozon Komisioni i Shëndetësisë.

Enver Roshi – E hedhim në votim. Kush është dakord?

Miratohet.

Edlira Bode – Për nenin 4, gjithashtu nuk kemi ndryshime dhe propozoj të votojmë variantin e qeverisë.

Enver Roshi – Kush është dakord?

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edlira Bode – Është marrë parasysh propozimi i OBSH-së në disa vende dhe në rastet ku i shikoni të shkruara, doktor, i kemi diskutuar bashkërisht dhe kanë qenë pa ndryshime në thelb me variantin që ka propozuar qeveria.

Në rastin e nenit 1, për shembull, thuhet: propozimi i qeverisë thotë “konsumon”, ndërsa propozimi i OBSH-së thotë “thith, përtyp, nuhat”. Meqenëse kanë qenë kështu pa ndryshime në thelb...

Ilir Pendavinji – Për procedurë.

Ndoshta këto duhen lexuar që të mbeten në rekordet e parlamentit, se ata kanë bërë një punë, ne i kemi kaluar, por ndërkohë duhet t’i kalojë edhe komisioni kur i voton nen për nen. Nuk mundet të kalohen propozimet pa u lexuar, të dalë propozimi që kemi ne, ose nga ministria, sido që të biem dakord, s’ka rëndësi, dhe pastaj të hidhen në votë.

Enver Roshi – Sugjeroj të lexohen propozimet e doktor Ilirit!

Edlira Bode – Doktor Iliri, dëshironi t’i lexoj sërish edhe ato që kaluam?

Enver Roshi – Kush është dakord me nenin 4?

Miratohet.

Edlira Bode – Edhe në nenin 5, po lexoj propozimin e OBSH-së: “Është e rëndësishme të ndalohen reklamat dhe promovimi i cigareve elektronike dhe kontejnerëve të rimbushjes”, ndaj sugjerohet të shtohet “Ndalimi i cigareve elektronike dhe kontejnerëve të rimbushjes së bashku me ndalimin e reklamimin e produkteve të duhanit”. Ose është e mundur të zbatohet neni 20 i direktivës së BE-së, i cili përmban dispozita lidhur me promovimin e cigareve elektronike dhe kontejnerëve të mbushjes.

Në fakt, neni 5 i propozuar nga ministria, ku në nenin 10 pas togfjalëshit “të produkteve të duhanit” shtohen fjalët: “cigaret elektronike, shisheve dhe nargjileve” është i plotë dhe përmbush edhe sugjerimin e OBSH-së, ndaj si komision propozojmë të votojmë propozimin e qeverisë.

Enver Roshi – Kush është dakord?

Miratohet.

Kalojmë te neni 6.

Edlira Bode – Për nenin 6 kemi një propozim nga biznesi, ku thuhet: “Të hiqet paragrafi i dytë i nenit 6, pasi produktet me shije karakteristike do të ndalohen në tregun e vendit”. Propozoj të mos e marrim parasysh këtë propozim të biznesit dhe të votojmë nenin 6 siç e propozon ministria.

Enver Roshi – Kush është dakord?

Miratohet.

Edlira Bode – Edhe për nenin 7 kemi një propozim nga biznesi: “fjalja e fundit të paragrafit të parë të nenit 13 të ndryshohet siç vijon: “Ndalohet promocioni dhe reklamimi direkt i produkteve të duhanit nëpërmjet logove dhe markave të regjistruara të produkteve të duhanit. Produktet e duhanit mund të paraqiten nëpër pikat e shitjes vetëm me paketimin e tyre origjinal”.

I propozoj kolegëve të votojnë nenin 7 sipas propozimit të ministrisë dhe të mos marrin parasysh sugjerimin e biznesit.

Enver Roshi – Kush është dakord me propozimin e ministrisë?

Miratohet.

Edlira Bode – Për nenin 8 propozojmë këtë përmbajtje: në nenin 19 dhe në gjithë përmbajtjen e tekstit të projektligjit, togfjalëshi “Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit”, të zëvendësohet me “Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit”, pasi mund të kemi një ndryshim të strukturës në të ardhmen dhe në ligj është më mirë të rrimë në përkufizime të përgjithshme.

Enver Roshi – Kush është dakord me propozimin e komisionit?

Miratohet.

Edlira Bode – Për nenin 9 kemi, gjithashtu, një riformulim të dakordësuar me përfaqësuesit e ministrisë, pasi duhet të përmbledheshin disa pika të dy neneve, si më poshtë: në nenin 20 bëhen këto shtesa dhe ndryshime, pas germës “a” të pikës 1, shtohet germa “a/a” me këtë përmbajtje: “Shkelja e nenit 7 dënohet me gjobë 500 mijë lekë për prodhuesit dhe/ose importuesit e produkteve të reja të duhanit”.

Pika 2. Pas pikës 1, të shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje: “Për shkelje të nenit 15 dy herë brenda një periudhe 3-mujore, subjekti i tatueshëm dënohet me gjobë sa dyfishi i gjobës së vendosur në nënndarjen “i”, të shkronjës “e” të këtij neni. Nëse subjekti i tatueshëm i penalizuar për herë të dytë gjendet përsëri në shkelje të nenit 15, brenda një afati kohor 1-vjeçar, atëherë ndaj tij vendoset gjobë në vlerën gjashtëfishi i gjobës së vendosur në nënndarjen “i”, të shkronjës “e” të këtij neni dhe pezullim të aktivitetit deri në shlyerjen e masave të gjobës”.

Propozoj ta hedhim nenin 9 në votim me këtë formulim.

Enver Roshi – Hidhet në votë neni 9 me variantin e komisionit. Kush është dakord?

Miratohet.

Edlira Bode – Për neni 10 propozojmë këtë përmbajtje: “Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të këtij ligji”.

Ju sugjeroj, i nderuar kryetar, t’i kërkojmë një mendim edhe ministrisë lidhur me këtë.

Enver Roshi – Fjala për përfaqësuesit e ministrisë.

Mira Rakacolli - Mund ta përsërisni edhe një herë, ju lutem, se nuk e kuptova! Bëhet fjalë për hyrjen në fuqi që Këshilli i Ministrave duhet të nxjerrë akte nënligjore që parashikon ligji?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besoj se po, se nga 6 muaj në 24 muaj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edlira Bode – Ka qenë i përgatitur kohë më parë dhe, në fakt, një pjesë e mirë e kësaj kohe ka kaluar, tashmë një periudhë 6-mujore është e mjaftueshme për hartimin e akteve.

Enver Roshi – A është i përgatitur sistemi ynë që të gjitha këto subjektet që importojnë, prodhojnë brenda harkut kohor 6-mujor të zbatojnë këto masa, apo u duhet më tepër kohë për të krijuar kushtet e nevojshme që ky ligj të hyjë në zbatim?

Vjollca Braho - Në qoftë se zbatimi i këtij ligji del në datën që do të përcaktoni ju, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, të gjitha inspektimet i ka online, kështu që do të ndryshojë vetëm masa e gjobës, nga 300 mijë lekë do të shkojë dyfish brenda 3 muajve dhe gjashtëfish brenda vitit, dhe pastaj futjen e masës së gjobës në momentet kur subjektet nuk kanë qenë të regjistruar në Ministrinë e Shëndetësisë, është futur 500 mijë lekë. Kështu që ne jemi gati vetëm me vendimin që do të nxirrni ju.

Enver Roshi – Kush është dakord me afatin 6 muaj?

E hedhim në votim për të gjitha aktet.

Miratohet.

Edlira Bode – Neni 11 “Hyrja në fuqi”: “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare me përjashtim të paragrafëve 1, 3 dhe 4 të nenit 6 të këtij ligji që hyn në fuqi 24 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare”.

Në fakt, edhe kjo është e dakordësuar edhe me grupin e punës së ministrisë , ndaj biem dakord ta votojmë nenin 11 kështu siç është.

Enver Roshi – Kush është dakord?

Miratohet.

Ka diskutime të tjera para se ta hedhim në votim ligjin në tërësi? Unë kam një pyetje, lidhur me një paqartësi ligjore, të paktën siç e mendoj unë: ku e ka të drejtën një subjekt që të ankohet në këtë ligj, apo ekziston në ligjin e mëparshëm?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka edhe një problem tjetër. Atij i rri mbyllur biznesi, marrja e vendimeve mund të vazhdojë për vite të tëra dhe ai falimenton. Si mund të zgjidhet në këtë rast?

Mira Rakacolli - Biznesi rri mbyllur deri në momentin që ka shlyer gjobën, në momentin që e ka bërë këtë, nuk ka më asnjë problem.

Enver Roshi – Ai mund ta hedhë në gjykatë, nuk paguan gjobën dhe gjyqi mund të vazhdojë 1 vit. Si veprohet në këtë rast?

Vjollca Braho - Ne nuk kemi ligj të ri, vetëm propozuam ndryshime në ligjin aktual. Kjo pjesë është e parashikuar në ligjin aktual, nuk është ligj i ri ky që do të votojmë sot, ka vetëm disa ndryshime.

Enver Roshi – Sa kohë vazhdon një proces gjyqësor për duhanin?

Mira Rakacolli - Ka procedura brenda 30 ditëve pas marrjes së masës administrative, baseni ka të drejtën për t'u ankimuar në Komisionin e Apelimit, që është në Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor dhe brenda 30 ditëve ka të drejtë për t'u ankuar në gjykatë.

Enver Roshi – Sa kohë vazhdon gjyqi pastaj?

Vjollca Braho - Varet se cilit gjyqtari i ka rënë çështja për shqyrtim, procedurat se si kanë qenë...

Enver Roshi – I bie që një biznes që ka frigoriferët me ushqime, të falimentojë apo të rrënohet...

Mira Rakacolli -Ju keni të drejtë po ta shikoni me syrin e biznesit për momentin, por po ta shikoni ligjin në tërësi, as biznesi nuk i qëndron, sepse kjo masë vihet në momentin që ai e ka shkelur 3 herë brenda 1 viti. Pra, i është dhënë hapësira një vit. Herën e parë e shkeli, pagoi gjobën dhe nuk iu mbyll edhe pse mund ta ankimojë gjobën; herën e dytë e shkeli, ta shkelë edhe herën e tretë, si i bie? Do të mendojmë për njerëzit, sepse kemi edhe eksperiencë të tilla që u vëmë gjoba dhe ata nuk i paguajnë dhe vazhdojnë aktivitetin. E çfarë fituam ne këtu? Si i mbrojtëm ne njerëzit?

Enver Roshi – Pyetja u bë për të sqaruar!

E hedhim ligjin në votim në tërësi? Kush është dakord?

Miratohet.

Suksese!